



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr. Prot Br. Prot Prot No
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages	Data Datum Date
DPK	03-02/3855/A7
02	21-11-2017
PRISTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 17.11.2017, mori:



V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2518/17, për z. Skender Ahmeti, Drejtor i Inspekcionit në Komunën e Vitisë, për shkak se zyrtari i lartë e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë z. Skender Ahmeti, Drejtor i Inspekcionit në Komunën e Vitisë, dhe njëkohësisht person i autorizuar, në biznesin privat "Skender Ahmeti" B.I, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari i lartë është njoftuar se gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të ushtroj funksion menaxherial në biznes privat, neni 15 (paragrafi 1), të Ligjit nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë është deklaruar se brenda afatit ligjor do të ndërmerr veprime për shmangien e gjendjes së konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar një shkresë zyrtare (DPKI.03-02/3769/17) me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë ka bërë shuarje vullnetare të biznesit privat të cekur më lartë. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

